



## PROCESVERBAL 4/2024

I Mbajtur në takimin e IV- të të rregulltë të KPF-së me datën **29.04.2024**, në sallën e vogël të takimeve në ora 10<sup>00</sup> nën kryesimin e Kryesuesit të KPF-së, Xhavit Zariqi, në prani të anëtarëve të saj, OJQ-ve dhe Zyrtarës për informim.

**Në mbledhje ishin të pranishëm:**

1. z. Xhavit Zariqi, Kryesues;
2. z. Arian Imeri, Anëtar;
3. znj. Lumnije Morina, Anëtare;
4. znj. Mimoza Pajaziti, Anëtare;
5. z. Lulzim Abazi, Anëtar;
6. z. Brahim Osmani, Anëtar;
7. znj. Hatixhe Bungu Qerimi, Anëtare;
8. z. Flamur Istrefi, Anëtar dhe

**Nënkryetari i komunës, Drejtorët e drejtorive;**

1. z. Lulzim Aliu - Nënkryetari i komunës;
2. znj. Sebahate Ajeti Sadiku - Drejtore e Buxhetit dhe Financave dhe
3. z. Kemajl Emini - Drejtor i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

**Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi** – Përshëndetje të pranishëm, anëtarë të kuvendit, shoqëria civile, Nënkryetar i komunës, Drejtor të drejtorive, pra po fillojmë me mbledhjen e IV-të të rregullt të KPF-së, besoi që materialin e keni marr me kohë dhe ju dëshiroi mirëseardhje në mbledhjen e KPF-së dhe propozojë këtë rend dite:

**Rendi i ditës:**

1. Konfirmimi i pjesëmarrjes në mbledhjen e KK-së;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes të kaluar të KK-së;
4. Propozim -Vendim për Themelimin e Forumit të Panelit për Transparencë Komunale për Kuvendin e Komunës së Ferizajt;

5. Propozim - Vendim për daljen në Diskutim publik të Statutit aktual të QKMF-së të Vitit 2016 si dhe Draft-Statutin Unik të QKMF-së të adaptuar me specifika të QKMF-së Ferizaj;
6. Raporti financiar për periudhën Janar-Mars 2024;
7. Pyetje dhe kërkesa dhe
8. Të ndryshme.

### **Pika Shtesë**

#### **1. Propozim – Vendim për bartjen e mjeteve THV nga Viti 2023 në Vitin 2024.**

##### **Pika 1**

**Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi** – Konfirmoi se në mbledhjen e KPF-së ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e KPF-së, përveç znj. Shqipe Jashari.

##### **Pika 2**

**Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi** – Lexoi pikën e rendit të ditës dhe theksoi se a ka dikush të flas për këtë rend dite, fjalën ia kaloi Sebahate Ajeti Sadiku - Drejtores të Buxhetit dhe Financave.

**Sebahate Ajeti Sadiku - Drejtores e Buxhetit dhe Financave** – Përshëndetje për të gjithë, faliminderit kryesues, në këtë rend të ditës e kemi sjellur edhe një pikë shtesë për kuvendin e komunës, është Propozim – Vendimi për bartjen e mjeteve THV nga Viti 2023 në Vitin 2024, qëllimi i kësaj pike është se e kemi marr barazimin nga thesari me vonesë mbasi janë dorëzuar pikat e kuvendit dhe sot është dashur që të mos humbim kohë më shumë, kur e dimë se po ka procedura edhe më tutje në ministri e të bëhet alokimi i të hyrave dhe e kërkoi votimin të hyrave vetanake që kjo pikë të kaloi në kuvend.

**Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi** – Faliminderit, dikush tjetër për rendin e ditës, mbasi nuk ka diskutime për Propozim – Vendimin për bartjen e mjeteve THV nga Viti 2023 në Vitin 2024, e hedhim në votim, kush është për; 8 vota për, 0 vota kundër dhe 0 vota abstenim, pra miratohet rendi i ditës.

##### **Pika 3**

**Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi** – Po fillojmë me pikën e III-të, Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të KPF-së, a ka dikush ndonjë çështje apo vërejtje për procesverbalin e mbledhjes së kaluar, kush është për miratimin e procesverbalit; 8 vota për, 0 vota kundër dhe 0 vota abstenim, pra miratohet procesverbali i mbledhjes së kaluar, vazhdojmë me pikën e IV –të.

#### **Pika 4**

**Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi** – Propozim - Vendim për Themelimin e Forumit të Panelit për Transparencë Komunale për Kuvendin e Komunës së Ferizajt, unë besoi që kjo pikë e rendit të ditës të kaloi për kuvend për tu diskutuar, kush është për miratimin e pikës së IV-të të dalë në kuvend; 8 vota për, 0 vota kundër dhe 0 vota abstenim, pra miratohet pika IV-të e rendit të ditës, po fillojmë me pikën e V-të të rendit të ditës.

#### **Pika 5**

**Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi** – Propozim - Vendim për daljen në Diskutim publik të Statutit aktual të QKMF-së të Vitit 2016 si dhe Draft-Statutin Unik të QKMF-së të adaptuar me specifika të QKMF-së Ferizaj, drejtor a ki me na thanë diçka rreth kësaj pike, apo po e procesojmë në kuvend.

**Kemajl Emini, Drejtor i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale** – Pershëndetje për të gjithë, Kryesues, anëtarë të kuvendit, Drejtor të drejtorive, media, kemi një propozim nga Ministria e shëndetësisë që afro 70% të komunave e kanë kryer këtë Draft Statut, unë besoi se është e arsyeshme sepse hapen shumë dyer të bashkëpunimit me Ambasadën e Zvicrës, mundet me u ba me aspektin financiar dhe aspektin e investime kapitale, po edhe në aspektin çështjes së trajnimeve të mjekëve, të ligjeratave të teknikëve dhe të punëtorëve të mesëm dhe në të njëjtën kohë është mundësuar edhe formimi i shoqatës për mbrojtjen e pacientëve si dhe rregulloreve dhe shumë çashtjeve brenda për brenda të QKMF-së, kontratat e reja në bazë të ligjit publik, koeficienti i punës të pozitive të punëtorëve, marrja e punëve dhe përgjegjësisive të reja, pozicionit simbas të vendit të punës, në bazë të këtij Statuti të punës, unë e di që janë edhe do delegacione, që unë jam personalisht me i ndryshu dhe kur të bëhet dëgjimi publik në kuvend, kam me i propozu e që do t'i dërgoi në ministri, nëse na kthen ministria, e nëse jo unë jam që me i rregullu sepse na qelin shumë dyer dhe që në nivel të Kosovës janë 70%, duhet ta kemi parasysh këtë Draft Statut, na e kemi pasur edhe para një viti që na nuk e kemi miratu, e në atë kohë Lipjani e ka miratu, e duhet me shiqu se çfar avancime ka ba Lipjani me ambasadën e Zvicrës veç e veç edhe në aspektin e investimeve kapitale edhe në aspektin e ligjeratave dhe trajnimeve të ndryshme dhe në aspektin e punëtorëve, faliminderit.

**Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi** – Faliminderit, a dëshiron dikush të diskutoi për pikën e V-të.

**Flamur Istrefi** – Drejtor shkurtimisht edhe vjet e kena pas këtë, propozimet e shyrimit publik nuk i kena marr parasysh asnjë propozim, d.m.th., na ki folë për këtë Drefit Statut dhe nuk u ndërmuar kurgja dhe ka dal në kuvend, e nuk ka kalu, a po mendon se këtë vit po kalon, apo e ki zgjedhë sa për sy e faqe apo ky propozim nuk ka me kalu, nëse është ashtu duhet me i thirr profesionistat, se për ndryshe nuk ki nevojë, këtë rast ashtu siç është edhe përfundon, keni pasur debat edhe në KPF edhe në Kuvend, kemi pasur paknaqësi edhe zgjedhjen e drejtorit edhe ne kemi thy rekordin, nëse nuk gabo, a e keni organizu mirë këto aplikacione apo e keni pru në versionin final.

**Kemajl Emini** – Unë e kam prurë këtu që me pas disa ndryshime dhe besoi se ministria prap nuk ka me pranë, po unë jam me kalu Statuti 70% e komunës, qysh ka kalu me rregullore dhe udhëzime, e tash qyshë vendosin kuvendarët edhe me dëgjim publik, veç me shku me pa se çfarë avansimi ka kjo në Lipjan, e shehë që është e pa imagjinueshme, është e arsyeshme, ministria ka qenë që të jetë unike, megjithatë vendos kuvendi, faliminderit.

**Nënkryetari i Komunës Lulzim Aliu** – Te qarkorja paskeni procedurë, pra duhet me u pajtue ministria, mi marr propozimet e mandej me u miratue në kuvend.

**Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi** – Faliminderit, meqenëse bëhet fjalë për diskutim publik, unë besoi që me vretje e sygjerime me kalu në kuvend, unë e di se herën e kaluar nuk ka kaluar në kuvend me plotë arsye edhe nëse nuk mundësohet në kuvend, asnjë ndryshim në kuptimin pozitiv, unë besoi që prap duhet me garu, pavarësisht që drejtori po mundohet me arsyetu se Lipjani ka fituar donacione, krejt për arsye të tjera, jo për shkak të Statutit, se Statutin donatorët nuk e kërkojnë, mund të jetë një arsye për dryshim, megjithatë unë e qesë në votim këtë propozim, a jeni që të kaloi në kuvend pika e V-të e rendit të ditës; 8 vota për, 0 vota kundër dhe 0 vota abstenim, pra miratohet pika V-të e rendit të ditës, po fillojmë me pikën e VI-të të rendit të ditës.

## **Pika 6**

**Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi** – Raporti financiar për periudhën Janar-Mars 2024, Drejtore e keni fjalën.

**Sebahate Ajeti Sadiku, Drejtore e Buxhetit dhe Financave** – Faliminderit Kryesues, sa i përket Raportit Financiar për periudhën Janar-Mars 2024, duke bërë krahasimin e të hyrave dhe shpenzimeve për këtë periudhë tre mujore të këtij viti, mund të themi se gjithsejtë të hyrat vetanake gjatë kësaj periudhe janë inkasuar në vlerë prej 1,330,445.55€, vlera e inkasuar në krahasim me vlerën e inkasuar të Vitit 2023 ka një rënie për 28.29%, ndërsa krahasuar me realizimin e planit kemi 24.59% edhe njëherë po e konsideroi se kjo rënie është për shkak të heqjes së obligimit të tatimit në pronë, e që e dimë se pagesa e këstit të parë e tatimit në pronë ka qenë data e fundit 30 Prill dhe po besojmë që gjatë muajve të ardhëshme këto të hyra do të rriten edhe më tutje dhe do të kemi një tejkalim sikurse në vitin e kaluar, sa i përket shpenzimeve sipas ligjit të shpenzimeve financiare, sipas buxhetit të Vitit 2024, Buxheti financiar i Komunës së Ferizajt është i paraparë që të jetë 41,184,014.00€, ndërkaq periudha Janar- Mars të Vitit 2024 buxheti i këtij viti do të karakterizohet me një vlerë reale të shpenzimeve buxhetore, ku deri me 31.03.2024 Buxheti i Vitit 2024 nga fondet burimore; Grant Qeveritar dhe të hyrat vetanake janë shpenzuar 10,906,551.15 apo 26.48% të buxhetit të aprovuar, në të gjitha programet dhe kategoritë buxhetore, pra edhe nëse shkojmë me ritëm të shpenzimeve buxhetore do të shpenzojmë të gjitha mjetet dhe nuk do të kemi deficit as për këtë vit, sa i përket të hyrat dhe shpenzimeve i keni të paraqitura edhe në Raportin të cilin e keni pranë vetës, faliminderit.

**Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi** – Faliminderit Drejtore, a ka dikush tjetër të diskutoi për Raportin financiar, a jeni që të kaloi në kuvend pika e VI-të e rendit të ditës; 8 vota për, 0 vota kundër dhe 0 vota abstenim, pra miratohet pika VI-të e rendit të ditës, pra kalon edhe po vazhdojmë me pikën e VII-të.

## **Pika 7**

**Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi** – Propozim - Vendim për bartjen e mjeteve të të hyrave vetanake nga Viti 2023 në Vitin 2024, Drejtore e keni fjalën.

**Sebahate Ajeti Sadiku - Drejtore e Buxhetit dhe Financave** – Ateherë sa i përket bartjes së të hyrave vetanake nga Viti 2023 në Vitin 2024, ne kemi paraqitur vlerën prej 1,269,634.92 cent, është kjo vlerë e cila është pjesë e tejkalimit të të hyrave nga viti i kaluar, e dimë se një pjesë e tejkalimit të të hyrave e kemi shfrytëzuar edhe në vitin e kaluar, të cilin e ka mundësuar edhe Ligji i buxhetit, ndërkaq mjetet të cilat kanë mbetur të pa shpenzuara sipas Ligjit të buxhetit 2024 neni 9 pika 6-të, e njësisia e ka vendosur që mjetet e pa shfrytëzuara nëpër programe të barten automatikisht në sistemin SMPG-së, ndërkaq për aprovim të kuvendit komunal kërkohet vetëm tejkalimi i të hyrave të cilat i tejkalojnë vjerat të cilat janë të paraqitura në Buxhetin e Vitit 2024, konkretisht nga tabela 4.1, ne kemi bërë propozimin që këto mjete t'i shpërndajmë në kategori ekonomike dhe në shpenzime komunale dhe subvencione dhe investime kapitale, në shpenzime komunale kemi nevojë që të bëjmë rritjen e vlerës së mjeteve për këtë vit, po ne kemi parapa gjithsejt 219,643.92 cent, që bëjmë bartjen nga tejalimi të hyrave të vitit të kaluar, në subvencione kemi propozuar gjithsejtë 750,000.00€ si dhe në investime kapitale gjithsejtë 300,000.00€, ua shpërndajta edhe materialin e kësaj pike, po besoi që ndoshta nuk është e nevojshme që t'i tregoi programet ku janë shpërndar, po megjithate po i lexoi prap, tek administrata e përgjithshme në vendimet komunale kemi vendosur t'i bartim gjithsejtë 219,643.92€, ndërkaq në subvencione kemi vendosur që në programin shërbime publike t'i bartim gjithsejtë 200,000.00€, këto 200,000.00€ do të thotë që të dedikohen për “Bashkësi islame” për shkak se ministria ka vendosur që kontratën të cilën e kemi lidhur nëpërmes Kuvendit të komunës me “Bashkësin islame” nuk na lejon që pagesën ta bëjmë nëpërmes mallrave dhe shërbimeve dhe ne nuk kemi pasur më herët subvencione të ndara për këtë kategori, për këtë jemi detyruar që të bëjmë një ndarje të tillë, tek administrata e shëndetësisë kemi planifikuar të bartim 100,000.00€, si dhe tek administrata e arsimit gjithsejtë 450,000.00€ që në total 750,000.00€ subvencione, ndërkaq në investime kapitale kemi propozuar që t'i bartim në dy projekte në Drejtorinë e Arsimit ku është më e nevojshme që janë në përfundim e sipër, sidomos njëri nga projektet që është duke u përfunduar, ku është ndërtimi i shkollës së mesme në Ferizaj, në arsimin e mesëm fondi 44149 kemi planifikuar që të bartim 250,000.00€, për shkak që jemi në përmbyllje të kontratës dhe që është e nevojshme që mjetet të barten në këtë projekt, si dhe te ndërtimi i shkollës së re në Neredime 50,000.00€ kodi 49853, faliminderit.

**Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi** – Faliminderit, a ka dikush të diskutoi?

**Flamur Istrefi** – Vetëm një pyetje Drejtore, tek subvencionet, tek administrata 450,000.00€, a ka të bëjë me qerdhe apo?

**Sebahate Ajeti Sadiku, Drejtore e Buxhetit dhe Financave** – Ka të bëjë me bursa të studentëve dhe jemi me vonesë dhe nuk kemi mjete të mjaftueshme për Drejtori të arsimit, për këtë arsye, qerdhet janë të lidhura me kontratë të prokurimit, duke u paguar nga mallra dhe shërbime dhe nuk kemi borgj asnjë faturë të tyre, jemi dakorduar, në seancën e kaluar është diskutuar çështja e KARITAS-it por që edhe unë e drejtori nuk kemi qenë në seancë, ka qenë procedurë e prokurimit sepse që nga Viti 2019 çerdhet edhe Kontrata e shëndetësisë janë duke proceduar përmes prokurimit publik, e që është kontratë e hapur edhe nuk ka pasur telashe edhe me çerdhe, është lidhur kontrata edhe janë duke u paguar rregullisht edhe punëtorët, faliminderit.

**Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi** – Dikush tjetër, mbasi nuk ka, po e kalojmë në kuvend pikën e VII-të të rendit të ditës; 8 vota për, 0 vota kundër dhe 0 vota abstenim, pra miratohet pika VII-të e rendit të ditës, pra kalon edhe po vazhdojmë me pikën e VIII-të, të ndryshme.

#### **Pika 8**

**Kryesuesi KPF-së Xhavit Zariqi** – A ka dikush të diskutoi për pikën në të ndryshme, mbasi nuk ka me kaq po e mbylli mbledhjen e KPF-së dhe shihemi në mbledhjen tjetër të radhës.

**Procesmbajtësja**

*Zylyha Tafarshiku*

**Zylyha Tafarshiku**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**



*Xhavit Zariqi*

**Xhavit Zariqi**